

20210240364

L I G J I ZHVILLIMIT TË BARASPESHUAR RAJONAL (*)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e ligjit

Neni 1

Ky ligj rregullon qëllimet, parimet dhe politikëbërësit për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, planifikimin e zhvillimit rajonal, financimin dhe shpërndarjen e mjeteve për promovimin e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe të projekteve dhe të çështjeve tjera të ngjashme që lidhen me zhvillimin rajonal.

Përkufizime

Neni 2

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1) "**Zhvillimi rajonal**" është një proces afatgjatë i promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe arrihet duke identifikuar, nxitur, menaxhuar dhe përdorur potencialet e zhvillimit të rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe fshatrave;

2) "**Zhvillimi i baraspeshuar rajonal**" është një proces i planifikimit të zhvillimit rajonal që synon zvogëlimin e pabarazive në shkallën e zhvillimit brenda dhe midis rajoneve planore për të arritur një zhvillim të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve;

3) "**Politika për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal**" është një sistem qëllimesh, instrumentesh dhe masash që synojnë zvogëlimin e pabarazive në nivelin e zhvillimit në dhe midis rajoneve planore dhe arritjen e një zhvillimi të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

4) "**Rajoni Planor**" është një njësi territoriale funksionale për statistikën e nivelit të tretë në përputhje me Nomenklaturën e Njësive Statistikore Territoriale NNJST 3, e krijuar për nevojat e planifikimit të zhvillimit dhe zbatimit të politikës për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal;

5) "**Planifikimi i zhvillimit rajonal**" është një proces i përcaktimit të qëllimeve realiste dhe koherente, të përparësive dhe të masave për nxiten e zhvillimit;

6) "**Strategjia e Zhvillimit Rajonal të republikës së Maqedonisë të Veriut**" është një dokument planifikimi afatgjatë që përcakton parimet, qëllimet dhe përparësitë e zhvillimit rajonal në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përcakton masat, instrumentet dhe mjetet financiare dhe mjetet tjera për zbatimin e tyre;

7) "**Programi për zhvillimin e rajonit planor**" është një dokument planifikimi afatmesëm i cili përcakton qëllimet e zhvillimit të rajonit planor dhe masat, instrumentet dhe mjetet financiare dhe mjetet tjera për zbatimin e tyre;

8) "**Programi për zhvillim të baraspeshuar rajonal**" është një dokument për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të Republikës së Maqedonisë të Veriut;

9) "**Plani i veprimt**" është një dokument i zbatueshëm, i cili shërben për funksionalizimin dhe zbatimin e programit për zhvillimin e rajonit planor dhe ofron një pasqyrë të plotë të strukturës së të gjitha masave, përkatësisht përpunimin e tyre dhe rishikimin e të gjitha aktiviteteve dhe projekteve për një periudhë prej një vjet;

* Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Rregullativën (BE) Nr. 1301/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit datë 17 dhjetor 2013, për Fondin Europian të Zhvillimit Rajonal dhe dispozitat e posaçme në lidhje me investimet me qëllim të promovimit të punësimit dhe shfuqizimin e Rregullativës (KE) Nr. 1080/2006 Celex 32013R1301.

10) "**Projekt zhvillimi**" është një projekt për ndërtimin / rindërtimin e infrastrukturës komunale, sociale dhe infrastrukturës tjetër, ndërtimin dhe forcimin e institucioneve shkencore dhe kulturore dhe projekte të tjera që ndikojnë në zhvillimin rajonal dhe konkurrencën rajonale;

11) "**Projekti rajonal**" është një projekt zhvillimi që del nga Programi për zhvillimin e rajonit planor, kontribuon në përdorimin e potencialeve të tij të zhvillimit dhe ka një ndikim më të gjerë në zhvillimin e rajonit dhe më gjerë;

12) "**Projekti sektorial**" është një projekt zhvillimi që zbatohet në përputhje me programin e zhvillimit të një ministrie kompetente, në mënyrë që të arrijë objektivat e fushës së punës së ministrisë kompetente dhe ka një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e përparësive të zhvillimit të rajonit planor;

13) "**Indeksi i zhvillimit**" është një tregues i përbërë që llogaritet si një mesatare e përlllogaritur e vlerave të standardizuara nga disa tregues ekonomikë, socialë dhe demografikë, në mënyrë që të përcaktohet niveli i zhvillimit të rajoneve planore;

14) "**Masat**" janë akte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) për zbatimin e politikës së zhvillimit të baraspeshuar rajonal;

15) "**Zonat urbane**" janë grumbullimet urbane dhe grumbullimet më të vogla, të përcaktuara si komuna me seli në qytet, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

16) "**Zhvillimi i qëndrueshëm urban**" është një proces i zhvillimit urban që arrihet nëpërmjet masave për ndërtimin dhe rinovimin e tyre, të ndërthurura me masa për të promovuar arsimin, zhvillimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit, në partneritet me palët e interesuara.

17) "**Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal të Republikës së Maqedonisë të Veriut**" është një organ për harmonizimin dhe bashkërendimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal dhe

18) "**Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor**" është një organ për harmonizimin dhe zbatimin e politikës së zhvillimit të rajonit planor.

II. QËLLIME DHE PARIME TË POLITIKËS PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARASPESHUAR RAJONAL

Qëllimet

Neni 3

Qëllimet e politikës për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal janë:

- zhvillim i baraspeshuar dhe i qëndrueshëm në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë të Veriut, bazuar në modelin e zhvillimit policentrik,

- zvogëlimin e pabarazive midis dhe brenda rajoneve planore dhe ngritjen e cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve,

- rritja e konkurrencës së rajoneve planore duke forcuar kapacitetin e tyre të inovacionit, përdorimin optimal dhe vlerësimin e burimeve natyrore, të kapitalit njerëzor dhe të veçorive ekonomike të rajoneve të ndryshme,

- ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të veçantë të rajoneve planore, si dhe afirmimin dhe zhvillimin e tyre,

- zhvillimin e zonave urbane,

- zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim,

- zhvillimin e fshatrave dhe

- mbështetjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar të komunave për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

Parime

Neni 4

Parimet e politikave për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal janë:

- programimi - ndërtimi i një sistemi shumëvjeçar të programimit dhe zbatimit të politikave për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal që përfshin identifikimin e përparësive dhe të masave të politikave, financimin, menaxhimin dhe kontrollin e tyre,
- partneriteti - bashkëpunim në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumenteve të planifikimit të zhvillimit rajonal midis organeve të qeverisjes qendrore dhe komunave, partnerëve ekonomikë dhe socialë dhe përfaqësuesve të tjerë të shoqërisë civile përkatëse,
- harmonizimi - qëllimet, përparësitë dhe masat në dokumentet e planifikimit për zhvillimin rajonal harmonizohen me qëllimet, përparësitë dhe masat në dokumentet strategjike të zhvillimit në nivel kombëtar dhe në dokumentet e programit për integrimin e Republikës së Maqedonisë të Veriut në Bashkimin Europian,
- bashkëfinancimi - bashkëfinancim i masave të politikave për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të Veriut, buxheteve komunale, fondeve të Bashkimit Europian dhe burimeve tjera ndërkombëtare, si dhe mjeteve nga subjektet juridike dhe individët vendas dhe të huaj,
- transparenca - informimi i rregullt, me kohë dhe objektiv i publikut mbi masat e politikave për të promovuar zhvillimin e baraspeshuar rajonal, si dhe sigurimin e qasjes së lirë në të dhëna për palët e interesuara,
- pjesëmarrja - përfshirje aktive e qytetarëve në procesin e krijimit dhe të zbatimit të politikës rajonale,
- subsidiariteti - përgatitja, zbatimi, kontrolli dhe vlerësimi i programeve dhe i masave për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal kryhen nga rajonet dhe komunat e planifikimit, përveç në rastet kur ato përjashtohen nga kompetenca e tyre ose nuk janë në kompetencat e organeve shtetërore dhe
- qëndrueshmëria - respektimi i përbërësve ekonomikë, socialë dhe mjedisorë të zhvillimit gjatë krijimit të politikës për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

III. PLANIFIKIM I ZHVILLIMIT RAJONAL

Rajonet planore

Neni 5

- (1) Rajone planore krijohen për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimin e masave dhe instrumenteve për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal.
- (2) Rajonet planore të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni janë njësitë statistikore territoriale në nivelin e tretë NJSTN 3, të përcaktuara në përputhje me nomenklaturën e njësitë statistikore territoriale.
- (3) Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka tetë rajone planore.

Zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rajonet urbane

Neni 6

- (1) Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe veçanërisht të dimensionit të tij urban, përcaktohen zonat urbane.
- (2) Zonat urbane janë komunat me seli në qytet, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(3) Në kuadër të Programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Rajonal sigurohet mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm urban nëpërmjet masave dhe aktiviteteve për ballafaqimin me sfidat ekonomike, klimatike, demografike, sociale dhe mjedisore që prekin zonat urbane, njëkohësisht duke marrë parasysh nevojën për të përmirësuar marrëdhëniet urbane-rurale.

Zonat me nevoja specifike zhvillimore

Neni 7

(1) Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimin e masave dhe instrumenteve specifike për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, përcaktohen zonat me nevoja specifike të zhvillimit.

(2) Zonat me nevoja specifike për zhvillim, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, janë:

- zona kufitare, rurale, kodrinoro-malore dhe zona të tjera për të cilat, për shkak të veçorive të tyre specifike, ekziston nevoja për një qasje të veçantë planifikimi dhe nxitjeje të zhvillimit nga shteti dhe

- fusha me interes të veçantë për zhvillimin e qëllimeve ekonomike, turistike, kulturore dhe qëllimeve të tjera strategjike të shtetit.

(3) Zona me nevoja specifike për zhvillim mund të shtrihet në zonën e një ose më shumë komunave, komunat dhe komunat e qytetit të Shkupit në kuadër të një ose më shumë rajoneve planore.

(4) Qeveria miraton një listë të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore me propozimin e Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(5) Lista e rajoneve me nevoja specifike për zhvillim shqyrtohet në çdo pesë vjet dhe në rast nevojë edhe më herët.

Neni 8

(1) Kriteret themelore të përcaktimit të zonave me nevoja specifike të zhvillimit janë veçoritë gjeografike, socio-ekonomike, historike dhe kulturore të zonës së komunave dhe komunave të qytetit të Shkupit dhe interesat e tjera strategjike të shtetit.

(2) Qeveria, me propozim të Këshillit, i vërteton me akt treguesit e përcaktimit të zonave me nevoja specifike për zhvillim.

Dokumentet e planifikimit

Neni 9

(1) Planifikimi i zhvillimit rajonal bëhet me dokumente planifikimi.

(2) Dokumentet e planifikimit harmonizohen me Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë të Veriut, dokumentet strategjike të zhvillimit në nivel nacional dhe dokumentet e programit për integrimin e Republikës së Maqedonisë të Veriut në Bashkimin Europian.

Neni 10

(1) Dokumentet e planifikimit për zhvillimin rajonal janë:

- Strategjia e Zhvillimit Rajonal të republikës së Maqedonisë të Veriut dhe

- Programi për zhvillimin e rajonit planor.

(2) Qeveria, me propozim të Ministrisë, e miraton programin e zbatimit të Strategjisë, për zbatimin e dokumentit të planifikimit, të përmendur me paragrafin (1) nënparagrafi 1 të këtij neni.

(3) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor do të miratojë një plan veprimi për zbatimin e dokumentit të planifikimit, të përmendur me paragrafin (1) nënparagrafi 2 të këtij neni.

(4) Dokumentet e planifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni përgatiten në bazë të Metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit, të përcaktuar nga ministri i Vetëqeverisjes Lokale (në tekstin e mëtejshëm: Ministri).

(5) Gjatë përgatitjes së dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal duhet patjetër të konsultohen palët e prekura në nivel nacional dhe lokal.

Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Maqedonisë të Veriut

Neni 11

(1) Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Maqedonisë të Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia) miratohet për një periudhë dhjetë vjeçare.

(2) Strategjia përgatitet nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), dhe me propozimin e Qeverisë miratohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të Veriut.

(3) Strategjia për periudhën e ardhshme të planifikimit do të miratohet jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të periudhës aktuale të planifikimit.

(4) Për zbatimin e Strategjisë miratohen tre programe, nga të cilat dy programet e para miratohen për një periudhë tre vjeçare dhe i treti për një periudhë katër vjeçare.

(5) Programet e paragrafit (4) të këtij neni miratohen nga Qeveria.

(6) Programet e përmendura në paragrafin (4) të këtij neni për periudhën e ardhshme të planifikimit do të miratohen jo më vonë se tre muaj para përfundimit të periudhës aktuale të planifikimit.

Neni 12

(1) Me Strategjinë përcaktohen:

- koncepti, përparësitë dhe qëllimet strategjike të zhvillimit të rajoneve planore, duke marrë parasysh parimet e politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal,
- masat dhe instrumentet për të nxitur zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave dhe
- financimi, institucionet dhe mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave të Strategjisë.

(2) Strategjia është baza për përgatitjen e programeve për zhvillimin e rajoneve planore.

Programi për zhvillimin e rajonit planor

Neni 13

(1) Programi për zhvillimin e rajonit planor miratohet për një periudhë pesë vjeçare.

(2) Programi për zhvillimin e rajonit planor do të përgatitet veçmas për secilin rajon planor, në përputhje me Strategjinë dhe dokumentet e programit për integrimin e Republikës së Maqedonisë të Veriut në Bashkimin Europian.

(3) Programi për zhvillimin e rajonit planor përgatitet nga Qendra, për zhvillimin e rajonit planor, në pajtim me Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit.

(4) Programi për zhvillimin e rajonit planor miratohet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor me pëlqimin paraprak të Këshillit të Zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

(5) Programi për zhvillimin e rajonit planor për periudhën e ardhshme të planifikimit do të miratohet jo më vonë se tre muaj para përfundimit të periudhës aktuale të planifikimit.

Neni 14

(1) Planet vjetore të veprimit do të miratohen për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor.

(2) Planet vjetore të veprimit për vitin e ardhshëm do të miratohen deri në fund të tremujorit të tretë të vitit aktual.

Neni 15

(1) Programi për zhvillimin e rajonit planor përcakton:

- qëllimet për zhvillimin e rajonit planor,
- masat dhe instrumentet për nxitjen e zhvillimit të rajonit planor,
- masat dhe instrumentet për nxitjen e zhvillimit të zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim nëse përcaktohen në rajon dhe fshatra dhe
- burimet financiare, dinamikat kohore dhe treguesit për monitorimin dhe vlerësimin për zbatimin e masave për të stimuluar zhvillimin.

(2) Programi përcakton përparësitë për zhvillimin e rajonit, përparësitë për zhvillimin e zonave urbane, zonat me nevoja specifike për zhvillim, nëse përcaktohen të tilla në rajon dhe fshatrat.

(3) Programi për zhvillimin e rajonit planor është baza për përgatitjen e planeve të njësive të vetëqeverisjes lokale në sferën e zhvillimit të tyre ekonomik, social, urban, ekologjik, kulturor dhe të tjera.

IV. BARTËSIT E POLITIKËS PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARASPESHUAR RAJONAL

Neni 16

(1) Bartës të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal janë:

- Qeveria,
- Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal,
- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe
- Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor.

(2) Byroja e Zhvillimit Rajonal dhe Qendrat e Zhvillimit të Rajoneve Planore marrin pjesë gjithashtu në planifikimin e zhvillimit të baraspeshuar rajonal dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit për zhvillim të baraspeshuar rajonal.

Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal

Neni 17

(1) Qeveria do të themelojë një këshill për zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

(2) Anëtarët e Këshillit të Zhvillimit Të baraspeshuar rajonal janë:

- Zëvendëskryeministri i ngarkuar me çështjet ekonomike, bashkërendimin me departamentet ekonomike dhe investimet,
- Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Sistemit Politik dhe i Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive;
- Zëvendëskryeministri i ngarkuar për çështjet europiane,
- Ministrat që i drejtojnë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, të Financave, të Ekonomisë, të Transportit dhe të Lidhjeve, të Arsimit dhe të Shkencës, të Punës dhe të Politikës Sociale, të Kulturës, të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe të Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Ekonomisë së Ujërave,
- kryetarët e këshillave për zhvillimin e rajoneve planore dhe
- kryetari i Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale.

(3) Drejtuesit e qendrave për zhvillimin e rajoneve planore dhe drejtori i Byrosë së Zhvillimit Rajonal mund të marrin pjesë në punën e Këshillit të Zhvillimit Të baraspeshuar rajonal.

(4) Shkencëtarët dhe profesionistët në fushën e zhvillimit rajonal gjithashtu mund të marrin pjesë në punën e Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal.

(5) Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal drejtohet nga Zëvendëskryeministri i ngarkuar me çështjet ekonomike, me bashkërendimin e departamenteve ekonomike dhe investimet.

(6) Në rast të pengesës ose mungesës së Zëvendëskryeministrit të ngarkuar me çështjet ekonomike dhe me bashkërendimin e departamenteve ekonomike dhe investimet, Këshilli drejtohet nga ministri i Vetëqeverisjes Lokale.

(7) Mënyra e punës së Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal përcaktohet me Rregullore.

(8) Ministria siguron mbështetje profesionale dhe administrativo-teknike për punën e Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal.

Neni 18

(1) Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal:

- harmonizon politikën për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal me politikat sektoriale dhe politikat makroekonomike të Republikës së Maqedonisë të Veriut,

- jep një mendim mbi projekt-strategjinë për zhvillimin rajonal,

- jep pëlqimin paraprak për programet për zhvillimin e rajoneve planore,

- përcakton Propozimin e treguesve nga neni 8 paragrafi (2) dhe neni 33 paragrafi (2) të këtij ligji,

- përcakton Propozim-Listë të rajoneve me nevoja specifike për zhvillim,

- përcakton Projekt-Vendimin për klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit,

- përcakton një propozim për financimin e projekteve specifike nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të Veriut, të destinuara për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe fshatrave,

- jep një mendim për raportin vjetor për zbatimin e projekteve specifike të destinuara për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të Veriut.

- jep një mendim mbi raportin vjetor për zbatimin e dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal të përgatitur nga Ministria,

- rishikon dhe jep një mendim mbi raportin vjetor mbi masat e zbatuara dhe aktivitetet e politikës për zhvillim të baraspeshuar rajonal, në përputhje me të dhënat e marra nëpërmjet sistemit elektronik të përmirësimit të bashkërendimit në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikës për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal, i cili dorëzohet nga Ministria,

- inicon shqyrtimin e çështjeve në fushën e zhvillimit rajonal që kërkojnë bashkërendim ndërmjet Qeverisë, komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit dhe aktorëve të tjerë të interesuar,

- bashkërendon dhe jep mendim për programet e propozuara të ministrive kompetente dhe mjetet e miratuara të buxhetit për financim nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të Veriut, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e baraspeshuar rajonal dhe

- shqyrton çështje të tjera në fushën e zhvillimit rajonal, në përputhje me ligjin.

(2) Mendimet nga paragrafi (1) nënparagrafi 11 të këtij neni paraqiten nga Ministria, për shqyrtim në ministritë kompetente dhe në Qeveri, brenda 15 ditëve nga mbajtja e seancës së Këshillit, për të cilin është dhënë mendimi.

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

Neni 19

(1) Ministria është përgjegjëse për ndjekjen e politikës së nxitjes së zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

(2) Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e tjera që marrin masa për të nxitur zhvillimin, përcakton dhe zbaton politikën për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, në përputhje me objektivat e politikës ekonomike të Qeverisë dhe dokumentet e programit për integrimin e Republikës së Maqedonisë të Veriut në Bashkimin Europian.

(3) Ministria kryen këto aktivitete:

- përgatit një propozim-strategji sipas nenit 11, paragrafi 1 të këtij ligji,
- siguron harmonizimin e Strategjisë me dokumentet e programit për integrimin e Republikës së Maqedonisë të Veriut në Bashkimin Europian,
- përgatit dhe i paraqet Qeverisë një raport vjetor mbi zbatimin e dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal,
- përgatit një Propozim-Program për zbatimin e Strategjisë sipas nenit 11, paragrafi 4 të këtij ligji, kujdeset për zbatimin e saj dhe ndërmerr aktivitete për monitorimin e realizimit të saj,
- përgatit bazën analitiko-dokumentare për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit strategjik dhe operacional për zhvillimin rajonal,
- siguron mbështetje profesionale dhe administrativo-teknike për punën e Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal,
- shpall thirrjet publike për financimin e propozim-projekteve të programit, të paraparë me nenin 57, paragrafi 1 të këtij ligji për zvogëlimin e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe rritjen e konkurrencës rajonale, bën pranimin, evidentimin dhe përpunimin e propozim-projekteve të dorëzuara, lidh kontrata për realizimin e projekteve të zgjedhura dhe monitoron shfrytëzimin e mjeteve të lejuara,
- përgatit një Projekt-Vendim për treguesit për llogaritjen e indeksit të zhvillimit të rajoneve planore,
- përgatit një Projekt-Vendim për treguesit për përcaktimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim,
- përgatit një Projekt-Vendim për klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit,
- përgatit një listë të propozimeve për fushat me nevoja specifike për zhvillim,
- siguron ndihmë profesionale për qendrat për zhvillimin e rajoneve planore në përgatitjen e programeve për zhvillimin e rajoneve planore,
- mbështet aktivitetet e qendrave për zhvillimin e rajoneve planore për të nxitur konkurrencën e rajonit planor,
- vlerëson harmonizimin e programeve për zhvillimin e rajoneve planore me Strategjinë dhe i dorëzon mendim Këshillit,
- vlerëson rëndësinë e programeve të Qeverisë dhe të buxhetit për zhvillimin e baraspeshuar rajonal që ministrinë kompetente dhe organet e tjera të administratës shtetërore paraqesin në Ministri dhe ia paraqesin Këshillit,
- përgatit Propozim-Vendime për financimin e projekteve specifike nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të Veriut, të destinuara për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave dhe ia paraqet Qeverisë,
- organizon dhe bashkërendon aktivitetet për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal,
- implementon sistem për bashkërendimin e planifikimit, të zbatimit, të monitorimit dhe të vlerësimit të politikës së zhvillimit të baraspeshuar rajonal dhe kujdeset për sigurimin e të dhënave të nevojshme në sistem në të gjitha institucionet e përfshira në zhvillimin e baraspeshuar rajonal,

- merret me detyra që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen, administrimin dhe përdorimin e sistemit elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikës së nxitjes së zhvillimit të baraspeshuar rajonal dhe

- merret me çështje të tjera për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, të përcaktuara me ligj.

Neni 20

(1) Ministria mban evidencë për potencialet e zhvillimit të rajoneve dhe planifikimit me rëndësi për zhvillimin rajonal.

(2) Ministri e përcakton mënyrën e mbajtjes, formën dhe përmbajtjen e evidencës nga paragrafi (1) të këtij neni.

Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor

Neni 21

(1) Krijohet një këshill për zhvillimin e rajonit planor për secilin rajon planor.

(2) Anëtarët e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor me të drejtë vote janë kryetarët e komunave që janë pjesë e rajonit planor dhe nga një përfaqësues nga shoqatat dhe bashkësia afariste, pa të drejtë vote.

(3) Seancën konstituive të Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor e thërret kryetari i komunës me numrin më të madh të banorëve në rajonin planifikues, brenda 30 ditëve nga dita e verifikimit të mandateve të kryetarëve të komunave.

(4) Në rast se kryetari i komunës nga paragrafi (3) i këtij neni nuk thërret seancën konstitutive brenda afatit të përcaktuar ligjor, Këshilli konstituohet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, të cilat mund të thirren nga kryetari i komunës, pjesë e rajonit planor.

(5) Anëtarët e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor që përfshin qytetin e Shkupit janë anëtarët nga paragrafi (2) i këtij neni dhe kryetari i qytetit të Shkupit.

(6) Në rast të mungesës së kryetarit, në seancat e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor, ai / ajo zëvendësohet nga një i autorizuar nga ai / ajo nga anëtarët e këshillit komunal.

(7) Anëtari, përfaqësues i shoqatave në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor zgjidhet me anë të thirrjes publike, për një mandat prej katër vjetësh.

(8) Thirrja publike për zgjedhjen e përfaqësuesit anëtar nga shoqatat në paragrafin (7) të këtij neni shpallet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor, brenda 30 ditëve nga konstituimi i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor dhe thirrja publike do të shpallet në dy medie të shkruara, njëra prej të cilave në gjuhën e folur nga të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase dhe në dy medie lokale ose rajonale, si dhe në faqen e internetit të Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor.

(9) Kriteret themelore për zgjedhjen e një anëtari, përfaqësuesi i shoqatave në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor të përmendur në paragrafin (7) të këtij neni janë:

- personat juridikë - aplikantë të jenë regjistruar të paktën dy vjet, me seli dhe aktivitet në territorin e një komune brenda rajonit planor,

- personat juridikë - aplikantë në përputhje me Statutin e organizatës për të vepruar në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal dhe

- personat juridikë - aplikantë të kenë zbatuar të paktën dy projekte në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal.

(10) Thirrja publike zhvillohet nga një komision i formuar nga Kryetari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor, i cili përbëhet nga tre anëtarë, përfaqësues të njësisë organizative përgjegjëse për zhvillimin ekonomik lokal të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit që janë pjesë e rajonit planor.

(11) Bazuar në thirrjen publike, komisioni shqyrton aplikacionet e paraqitura dhe përpilon një listë të shoqatave që plotësojnë kriteret nga njoftimi.

(12) Kushtet e hollësishme për aplikimin dhe zgjedhjen e një anëtari, përfaqësues i shoqatave nga paragrafi (7) i këtij neni, përcaktohen në thirrjen publike.

(13) Kandidatët e regjistruar, të cilët plotësojnë kriteret nga thirrja publike, me shumicë votash vendosin se cilët prej tyre do të përfaqësohen në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor, në një takim të organizuar nga kryetari i komisionit, brenda 15 ditëve nga përfundimi i thirrjes publike.

(14) Kryetari i komisionit është i detyruar t'u dërgojë ftesë zyrtare shoqatave që kanë aplikuar për thirrjen publike nga paragrafi (8) i këtij neni.

(15) Ftesa nga paragrafi (14) i këtij neni do të publikohet në uebfaqen e Qendrës së paku tre ditë para datës së takimit.

(16) Mandati nga paragrafi (7) të këtij ligji përfundon për përfaqësuesin anëtar të shoqatave:

- pas përfundimit të mandatit,
- në rast vdekjeje.

(17) Përfaqësuesi anëtar i shoqatave mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit të përmendur në paragrafin (7) të këtij neni, nëse:

- do të kërkojë vetë një gjë të tillë,
- me shkarkimin nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor me propozim të kryetarit të Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor, me shumicën e dy të tretave,
- nëse është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për një vepër penale me një dënim të pakushtëzuar me burgim prej të paktën gjashtë muajsh,
- nuk merr pjesë në punën e këshillit, tre seanca radhazi, dhe
- nëse shkarkimi kërkohet nga shoqatat që e zgjedhën atë me shumicë votash.

(18) Nëse brenda 30 ditëve nga konstituimi i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor nuk thirret një thirrje publike për zgjedhjen e një anëtari, një përfaqësues i shoqatave, thirrja publike shpallet nga Ministri.

(19) Një përfaqësues nga bashkësia afariste në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor zgjidhet nga radhët e shoqatave përfaqësuese të punëdhënësve nga rajoni i planifikimit.

(20) Kryetari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor brenda 30 ditëve nga dita e konstituimit të Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor paraqet një kërkesë me shkrim tek shoqatat përfaqësuese të punëdhënësve për emërimin e një përfaqësuesi nga bashkësia e biznesit.

(21) Nëse ekziston vetëm një shoqatë përfaqësuese e punëdhënësve në rajonin e planifikimit, ajo do të propozohet nga anëtari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim nga kryetari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor.

(22) Nëse ka më shumë se një shoqatë përfaqësuese të punëdhënësve në rajonin e planifikimit, zgjedhja e anëtarit në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor bëhet nga shoqata që ka numrin më të madh të anëtarëve nga ai rajon.

(23) Kryetari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor zgjidhet nga kryetarët e komunave që janë anëtarë të Këshillit, për një mandat prej një viti, pa të drejtë të rizgjidhet.

(24) Në punën e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor mund të marrin pjesë ekspertë të fushës së zhvillimit rajonal, kryetarë të këshillave të njëjësive të vetëqeverisjes lokale si dhe përfaqësues të institucioneve kombëtare dhe organizatave donatore.

Neni 22

(1) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor kryen këto punë:

- organizon dhe bashkërendon aktivitetet për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal,
- miraton një Program për zhvillimin e rajonit planor, me pëlqimin paraprak të Këshillit,
- miraton Planin vjetor të veprimit për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor,

- përcakton listën vjetore të projekteve për zhvillimin e rajonit planor,
- paraqet propozime në Ministri, për identifikimin e zonave me nevoja specifike zhvillimore brenda rajonit planor, në përputhje me kriteret e nenit 8 të këtij ligji,
- siguron bashkërendimin e aktiviteteve të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, shoqatave, organeve shtetërore dhe institucioneve brenda rajonit që veprojnë në fushën e zhvillimit rajonal,
- fillon shqyrtimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin rajonal për të cilat është i nevojshëm bashkërendimi midis komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit dhe partnerëve nga sektori privat dhe civil,
- promovon bashkëpunimin ndërkuftar me rajone nga vendet e tjera bazuar në interesat e përbashkëta dhe
- kryen veprimtari të tjera në fushën e zhvillimit rajonal të përcaktuara me ligj.

(2) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor miraton dhe i paraqet Ministrisë raportin vjetor për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor, jo më vonë se 31 marsi i vitit aktual, për vitin paraprak.

Neni 23

(1) Mënyra e punës së Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor përcaktohet me Rregullore.

(2) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(3) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor, zakonisht mban seanca në selinë e komunës më të madhe sipas numrit të banorëve në rajonin planifikues ose në komunën ku zgjidhet kryetari i Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor.

(4) Kryetari i Këshillit, sipas nevojës, mund të caktojë dhe drejtojë seancën e Këshillit edhe me ndihmën e mjeteve të komunikimit (telefon ose lidhje konference me përdorimin e Internetit dhe veglave softuerike).

(5) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor i realizon punët profesionale dhe administrativo-teknike për Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor.

Byroja për zhvillimin rajonal

Neni 24

(1) Byroja e Zhvillimit Rajonal (në tekstin e mëtejshëm: Byroja) është organ brenda Ministrisë me kapacitetin e një personi juridik përgjegjës për zbatimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

(2) Drejtori i Byrosë emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria, për një periudhë katër vjeçare.

(3) Një person, i cili plotëson kushtet e mëposhtme, mund të emërohet si drejtor i Byrosë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë të Veriut,
- në momentin e emërimit me një vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar asnjë dënim ose sanksion për kundërvajtje, ndalim për të ushtruar një profesion, veprimtari ose detyrë,
- të ketë fituar të paktën 240 kredi sipas SETK-së, përkatësisht të ketë përfunduar arsimin e shkallës VII / 1 në fushën e shkencave juridike, ekonomisë ose shkencave teknike,
- të ketë përvojë pune të paktën pesë vjet, nga të cilat të paktën dy vjet në një pozicion menaxhues,
- të keni një nga certifikatat e mëposhtme të njohura në nivel ndërkombëtar për njohjen e gjuhës angleze, jo më e vjetër se dy vjet:
 - a) TOEFL me të paktën 74 pikë,
 - b) IELTS me të paktën 6 pikë,
 - c) ILEC (Cambridge English: Legal) me të paktën nivelin B2,

ç) FCE (Cambridge English: First) – me provim,

d) BULATS me të paktën 60 pikë ose

dh) APTIS - të paktën niveli B2.

- njohuri aktive të programeve kompjuterike;

(4) Mandati i drejtorit mbaron:

- në fund të mandatit të tij,

- duke ushtruar të drejtën për pension në përputhje me ligjin,

- në rast vdekjeje.

(5) Drejtori mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit nga paragrafi (2) i këtij neni në rastet më poshtë:

- nëse e kërkon vet,

- nëse shkarkohet nga Qeveria,

- nëse humbet përgjithmonë aftësinë për të ushtruar funksionin,

- nëse është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për vepër penale me burgim të pakushtëzuar së paku gjashtë muaj ose

- kryen veprimtari që nuk përputhen me funksionin e drejtorit të Byrosë.

Neni 25

Byroja kryen këto aktivitete:

- zbaton aktivitete që kontribuojnë në arritjen e objektivave të politikës të përcaktuara në dokumentet e planifikimit për zhvillimin e baraspeshuar rajonal,

- dorëzon njoftim në qendrat për zhvillimin e rajoneve planore për mbledhjen e propozimeve të projekteve për mjetet nga neni 37 paragrafi (2) nënparagrafi 1 e këtij ligji,

- shpall thirrjet publike për mbledhjen e propozimeve të projekteve për mjetet nga neni 37 paragrafi (2) paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij ligji,

- siguron mbështetje profesionale për qendrat për zhvillimin e rajoneve planore, komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit kur aplikojnë projekt propozime për mjetet e nga neni 37 paragrafi (2) të këtij ligji,

- bën pranimin, evidentimin dhe përpunimin e projekt-propozimeve të paraqitura për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal,

- përgatit dhe dorëzon listat e propozimeve të projekteve të aplikuara për zhvillimin e rajoneve planore, zhvillimin e zonave urbane, zhvillimin e fshatrave dhe zhvillimin e zonave me nevoja specifike të Kryetari i Komisionit për vlerësimin e projekteve,

- zbaton Vendimin për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, zhvillimin e zonave urbane, zhvillimin e fshatrave dhe zhvillimin e zonave me nevoja specifike të zhvillimit të përmendura në nenin 53 të këtij ligji;

- lidh marrëveshje për realizimin e projekteve nga neni 53 të këtij ligji;

- siguron mbështetje profesionale për qendrat për zhvillimin e rajoneve planore dhe njësisive të vetëqeverisjes lokale në realizimin e projekteve nga neni 53 të këtij ligji dhe në kryerjen e aktiviteteve në lidhje me zhvillimin e baraspeshuar rajonal;

- monitoron përdorimin e mjeteve të shpërndara për projekte për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal nëpërmjet Programit për zhvillim të baraspeshuar rajonal;

- përgatit një raport vjetor për zbatimin e projekteve të përmendura në nenin 53 të këtij ligji dhe ia paraqet atë Ministrisë deri në fund të tremujorit të parë të vitit vijues, për vitin paraprak;

- vendos dhe kujdeset për mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit për zbatimin e projekteve nga neni 53 të këtij ligji,

- merr pjesë në përgatitjen e bazës analitiko-dokumentare për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit strategjik dhe operacional për zhvillimin e baraspeshuar rajonal;

- Byroja organizon, zbaton dhe bashkërendon vizitat në terren për monitorimin e mënyrës së realizimit të projekteve nga neni 56 të këtij ligji,

- mund të zhvillojë aktivitete për uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe për rritjen e konkurrencës rajonale, dhe
- mund të ushtrojë veprimtari të tjera në fushën e zhvillimit të baraspeshuar rajonal të përcaktuara me ligj.

Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor

Neni 26

- (1) Do të themelohet një qendër për zhvillimin e rajonit planor për kryerjen e veprimtarive profesionale me rëndësi për zhvillimin e rajonit planor.
- (2) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor themelohet për secilin rajon planor.
- (3) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor themelohet nga njësitë e vetëqeverisjes lokale që janë pjesë e rajonit planor.
- (4) Në rajonin e planifikimit në të cilin përfshihet qytetit i Shkupit, qendrën e zhvillimit e formojnë komunat në përbërje të rajonit planor dhe qyteti i Shkupit.
- (5) Akti për themelimin e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor rregullon organizimin, punën dhe financimin e saj. Akti për themelimin e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor urdërohet Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale.
- (6) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor vepron si një subjekt juridik.
- (7) Selia e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor është në komunën me numrin më të madh të banorëve në rajonin planifikues.
- (8) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor ka një drejtor, i cili zgjidhet nëpërmjet një njoftimi publik.
- (9) Drejtori i Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor zgjidhet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor, me dy të tretat e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
- (10) Mandati i drejtorit të Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor është katër vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- (11) Konkursi publik për zgjedhjen e drejtorit të Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor do të shpallet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor brenda 15 ditëve nga dita e mbarimit të mandatit të Drejtorit të Qendrës.
- (12) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor cakton ushtruesin e detyrës Drejtor të Qendrës deri në zgjedhjen e drejtorit të ri nga radha e punonjësve të Qendrës.
- (13) Konkursi Publik nga paragrafi (8) i këtij neni do të publikohet në të paktën tre gazeta ditore të botuara në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore, nga të cilat në njërin nga gazetat e botuara në gjuhën e folur nga të paktën 20% e qytetarëve të cilët flasin një gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Neni 27

- (1) Një person që plotëson kushtet e mëposhtme mund të zgjidhet drejtor i Qendrës:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
 - në momentin e emërimit me një vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar asnjë dënim ose sanksion për kundërvajtje, ndalesë për të ushtruar një profesion, veprimtari ose detyrë,
 - të ketë fituar të paktën 240 kredi sipas SETK-së, përkatësisht të ketë përfunduar arsimin e shkallës VII / 1 në fushën e shkencave juridike, ekonomike ose teknike,
 - të ketë përvojë pune të paktën pesë vjet, nga të cilat të paktën dy vjet në një pozicion drejtues të projekteve zhvillimore të fushës së zhvillimit lokal dhe rajonal,
 - të ketë një nga certifikatat e mëposhtme të njohura në nivel ndërkombëtar për njohjen e gjuhës angleze, jo më të vjetër se dy vjet:
 - a) TOEFL me të paktën 74 pikë,

- b) IELTS me të paktën 6 pikë,
 - c) ILEC (Cambridge English: Legal) me të paktën nivelin B2,
 - ç) FCE (Cambridge English: First) – me provim,
 - d) BULATS me të paktën 60 pikë ose
 - dh) APTIS - të paktën niveli B2.
- njohuri aktive të programeve kompjuterike;
- (2) Mandati i drejtorit mbaron:
- në fund të mandatit të tij,
 - duke ushtruar të drejtën për pension në përputhje me ligjin,
 - në rast vdekjeje.
- (3) Drejtori mund të shkarkohet përpara përfundimit të mandatit nga paragrafi (2) i këtij neni nëse:
- e kërkon vet,
 - shkarkohet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor,
 - ka humbur përgjithmonë aftësinë për të ushtruar funksionin, gjë që vërtetohet nga një certifikatë e përshtatshme mjekësore,
 - nëse ndalesa e kryerjes së një profesioni, veprimtarie ose detyre është shqiptuar me vendim gjyqësor të formës së prerë,
 - është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për një vepër penale me një dënim të pakushtëzuar me burgim prej të paktën gjashtë muajsh ose
 - kryen veprimtari që nuk përputhen me pozicionin - Drejtor i Qendrës.
- (4) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor mund të shkarkojë drejtorin para përfundimit të mandatit me vendim të miratuar nga shumicë prej 2/3 të anëtarëve me të drejtë vote nëse:
- nuk realizon programin për zhvillimin e rajonit planor dhe planin e veprimit për zbatimin e tij,
 - për fajin e tij, Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor do t'i shkaktohet dëm,
 - nuk punon në përputhje me ligjin ose
 - në rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- (5) Në rast se nuk do të zgjidhet Drejtori i Qendrës ose mandati do t'i mbarojë më herët, Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor do të emërojë ushtrues të detyrës drejtor pa shpallje publike nga radha e punonjësve të Qendrës për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj.
- (6) Ushtruesi i detyrës së drejtorit ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e drejtorit të një qendre.
- (7) Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor menjëherë pas emërimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit do të shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.

Neni 28

- Drejtori i Qendrës:
- përfaqëson Qendrën,
 - menaxhon pronën e Qendrës dhe është nënshkrues i llogarisë së Qendrës,
 - propozon planin vjetor financiar dhe llogarinë përfundimtare vjetore të Qendrës,
 - miraton një rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Qendrës, pas një mendimi pozitiv të mëparshëm nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor,
 - menaxhon shërbimin profesional të Qendrës,
 - i propozon Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor programe, projekte, raporte dhe dokumente të tjera që përgatiten nga Qendra dhe duhet të miratohen nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor,
 - drejton procesin e monitorimit të zbatimit të programit për zhvillimin e rajonit planor, sipas nenit 13 të këtij ligji,
 - drejton dhe bashkërendon aktivitetet lidhur me zbatimin e Programit të Ministrisë, sipas nenit 11 paragrafi 4 të këtij ligji, nën kompetencat e Qendrës,

- drejton përgatitjen e projekteve për zhvillimin e rajonit planor,
- drejton procesin e zbatimit të projekteve të miratuara për zhvillimin e rajonit planor,
- iniciacion dhe fillon bashkëpunim me organe të tjera kompetente shtetërore dhe me organizatat donatore që mbështetin projektet për zhvillimin e Rajonit planor dhe komunave në përbërje të rajonit,
- siguron përdorimin e duhur dhe ligjor, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë së Qendrës,
- merret me çështje të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 29

- (1) Qendra ka një shërbim profesional, i cili është i organizuar në sektorë dhe departamente.
- (2) Vendimi për organizimin e shërbimit profesional të Qendrës merret nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor, me propozimin e drejtorit të Qendrës.
- (3) Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve të shërbimit profesional të Qendrës rregullohen në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës dhe ato nuk kanë statusin e nëpunësit administrativë.
- (4) Rrogën e drejtorëve të qendrave e cakton Ministri me pëlqimin paraprak të Qeverisë, varësisht numrit të punonjësve të Qendrës dhe angazhimeve lidhur me punën dhe kohën e nevojshme për realizimin e punës.
- (5) Shuma e rrogave të drejtorëve të qendrave caktohet me koeficientin 2,9 deri 3,4 dhe në rastin konkret, koeficientin e cakton Ministri me pëlqim paraprak të Qeverisë. Baza për përlogaritjen e koeficientit do të jetë në shumën e rrogës minimale neto të cilën ministri i Punës dhe i Politikës Sociale do ta botojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (6) Numri i punonjësve të qendrave dhe rrogat e tyre i cakton Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor.

Neni 30

- (1) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor zbaton aktivitete dhe realizon detyra në lidhje me përparësitë e zhvillimit të rajonit planor, si më poshtë vijon:
 - përgatit një Propozim-Program për zhvillimin e rajonit planor,
 - përgatit një plan të propozuar të veprimit për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor,
 - përgatit projekte për zhvillimin e rajonit planor,
 - bashkërendon aktivitetet në lidhje me zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor,
 - zbaton projektet për zhvillimin e rajonit planor,
 - përgatit një raport vjetor për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit planor,
 - siguron informacion për palët e interesuara mbi rrjedhën e zbatimit të Programit për zhvillimin e rajonit planor dhe çështje të tjera që lidhen me zhvillimin rajonal,
 - siguron ndihmë profesionale dhe teknike për komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit në përgatitjen e programeve të tyre të zhvillimit,
 - siguron shërbime profesionale për shoqatat dhe palët e tjera të interesit për përgatitjen e projekteve në fushën e zhvillimit rajonal,
 - inkurajon bashkëpunimin ndërkomunal brenda rajonit planor,
 - përgatit, paraqet aplikacione dhe zbaton projekte për të nxitur zhvillimin e rajonit planor, të financuar nga fondet e Bashkimit Europian dhe burime të tjera ndërkombëtare,
 - promovon mundësitë e zhvillimit të rajonit planor,
 - zbaton aktivitete për të nxitur konkurrencën nëpërmjet mbështetjes aktive të sektorit privat,
 - kryen punë profesionale dhe administrativo-teknike për nevojat e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor,
 - përgatit dhe zbaton projekte, detyra dhe shërbime për ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore dhe

- kryen veprimtari të tjera për të nxitur zhvillimin e rajonit planor.

Neni 31

(1) Aktivitetet dhe detyrat e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor për vitin aktual, të cilat dalin nga përparësitë e zhvillimit të rajonit planor, miratohen nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor me propozim të Ministrisë.

(2) Aktivitetet dhe detyrat e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor për vitin aktual përcaktohen me marrëveshje bashkëpunimi për vitin aktual, të lidhur ndërmjet Ministrisë dhe qendrave për zhvillimin e rajoneve planore.

(3) Marrëveshja e paragrafit (2) të këtij neni përmban aktivitete specifike në lidhje me përparësitë e zhvillimit të rajonit planor në vitin aktual, shumën dhe mënyrën e pagesës së mjeteve për realizimin e aktiviteteve dhe detyrave të përcaktuara, mënyrën dhe afatet për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara dhe detyrat dhe mënyra e veprimit në rast të mospërbushjes së pjesshme ose të plotë të detyrimeve të kontraktuara.

(4) Mjetet për realizimin e aktiviteteve dhe detyrave të përcaktuara në marrëveshjen e paragrafit (2) të këtij neni, në nivel vjetor, sigurohen nga Ministria në vlerë të barabartë ose më të madhe se shuma e paguar në vitin para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Komunitat, komunitat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, që janë shfrytëzues të fundit të projekteve të përmendura në nenin (37) paragrafi 2 nënparagrafi 1 të këtij ligji, i paguajnë Qendrës për realizimin dhe zbatimin e projektit mjete në vlerë deri në 15% të vlerës së projektit (e vlerësuar).

(6) Kriteret themelore për shumën e mjeteve për projektet që komunitat ua paguajnë qendrave të paragrafit (5) të këtij neni janë si më poshtë vijon:

- lloji dhe ndërlikueshmëria e projektit dhe
- shuma e projektit

(7) Ministri i cakton kriteret e e përafërta në lidhje me shumën e mjeteve që paguhen për Qendrën, sipas paragrafit (6) të këtij neni.

(8) Mjetet nga paragrafi (5) i këtij neni komunitat, komunitat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit do t'i transferojnë në llogarinë e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor, para fillimit të procedurës së furnizimit publik, por jo më vonë se 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës për realizimin e projektit, sipas nenit 55 paragrafi 1 të këtij ligji.

(9) Komunitat që nuk do të paguajnë mjetet nga paragrafi (5) i këtij neni, humbin të drejtën e përdorimit të mjeteve dhe në rastin konkret qendrat do të arkëtojnë mjetet e kontraktuara nga mjetet që do të ndahen për realizimin e projektit, ndërsa mjetet e tjera do të alokohen për financimin e projekteve nga lista e projekteve të vlerësuara pozitivisht.

(10) Qendra mund të përdorë mjete shtesë për financimin e detyrave dhe aktiviteteve të saj nga komunitat brenda rajonit planor – në rajonin e planifikimit në përbërje të të cilit është qyteti i Shkupit – nga komunitat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, në bazë të vendimeve të marra nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor ose nga këshilli i njësisve të vetëqeverisjes lokale, këshilli i komunës së qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(11) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor do t'i realizojë aktivitetet e nenit 30 paragrafi (1) nënparagrafi 16 të këtij ligji në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur me porositësin dhe në bazë të mendimit pozitiv të dhënë më parë nga Ministria dhe me pëlqimin e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor.

Neni 32

(1) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor do të paraqesë raportin vjetor të nenit 30 paragrafi 1 nënparagrafi 7 të këtij ligji Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor dhe këshillave të njësisve të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

(2) Një pjesë integrale e raportit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni është raporti për operacionet financiare të Qendrës.

(3) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor do të paraqesë raportin vjetor të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, pas miratimit të tij nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor dhe nga këshillat e komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit dhe në ministrinë kompetente, deri në fund të tremujorit të parë në vitin e ardhshëm, për vitin paraprak.

V. PËRCAKTIMI I NIVELIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE PLANORE

Neni 33

(1) Llogaritja e nivelit të zhvillimit të rajoneve planore do të kryhet në bazë të indeksit të zhvillimit.

(2) Qeveria, me propozim të Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal, me vendim përcakton treguesit dhe llogaritja e vlerës së indeksit të zhvillimit.

(3) Ministri zbaton procedurat e përcaktimit të nivelit të zhvillimit të rajoneve.

(4) Me kërkesë të ministrit, organet kompetente shtetërore janë të detyruara që të paraqesin të dhënat e nevojshme për përcaktimin e nivelit të zhvillimit të rajoneve planore.

(5) Niveli i zhvillimit të rajoneve planore përcaktohet për një periudhë pesë vjeçare, por sipas nevojës mund të përcaktohet edhe për një periudhë më të shkurtër.

Vendimi për klasifikimin sipas nivelit të zhvillimit

Neni 34

(1) Qeveria merr Vendim për klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit.

(2) Vendimi i paragrafit (1) të këtij neni miratohet pas llogaritjes së kryer nga neni 33 të këtij ligji.

VI. FINANCIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL

Burimet e financimit të zhvillimit rajonal

Neni 35

(1) Burimet e financimit të zhvillimit rajonal janë:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- buxhetet e komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit,
- Mjetet e Bashkimit European,
- burime të tjera ndërkombëtare,
- donacione dhe sponsorizime nga persona fizikë dhe juridikë dhe
- mjete të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të shpërndahen për çdo vit mjetet në vlerë prej të paktën 1% të PVB-së, për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

(3) Për të nxitur zhvillimin e rajonit planor, komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, gjithashtu mund të përdorin mjete nga mjetet e Bashkimit European.

(4) Përdorimi i mjeteve nga paragrafi (3) i këtij neni zbatohet në bazë të dispozitave të Marrëveshjes kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit European për rregullat e bashkëpunimit, në lidhje me ndihmën financiare të Komisionit European për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmën e paraanëtarësimit (IPA), të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Mjetet e paragrafit (1) të këtij neni mund të lidhen me mjete nga donacione dhe sponsorizime nga persona fizikë dhe juridikë për të zbatuar një program ose projekt për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal, me përjashtim të mjeteve nga paragrafi (1), nënparagrafi 3 të këtij neni.

(6) Mjetet nga paragrafi (1) nënparagrafi 5 e këtij neni caktohen dhe shpërndahen në përputhje me kushtet e marrëveshjes së dhurimit, përkatësisht sponsorizimit.

Instrumente për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal

Neni 36

(1) Instrumentet për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë:

- investime kapitale,
- grante të pakthyeshme,
- subvencione,
- hua me kushte të favorshme,
- sigurimin e garancive të huas,
- sigurimi i kredisë,
- stimuj tatimorë,
- lizingu dhe
- instrumente të tjera në përputhje me ligjin.

(2) Për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal bëhet financimi dhe bashkëfinancimi i përgatitjes së analizave, të studimeve, të dokumenteve planifikuese, të planeve të veprimit dhe të dokumenteve të projektit që plotësojnë kushtet për financim, si dhe financimi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale për zhvillimin rajonal në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

VII. SHPËRNDARJA DHE ALOKIMI I MJETEVE TË PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN RAJONAL / NËNPROGRAMI ZHVILLIMI I BARASPESHUAR RAJONAL

Shpërndarja e mjeteve nga Programi për zhvillim të baraspeshuar rajonal

Neni 37

(1) Mjetet nga neni 35 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të këtij ligji për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal shpërndahen me një vendim të miratuar nga Qeveria.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni shpërndahen si më poshtë:

- 55% për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore,
- 15% për financimin e projekteve për zhvillimin e zonave urbane dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe urban.
- 15% për financimin e projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim.
- 15% për financimin e projekteve të zhvillimit rural.

Neni 38

Mjetet nga neni 37 paragrafi (2) nënparagrafi 1 të këtij ligji do t'u jepen qendrave për zhvillimin e rajoneve planore, në përputhje me klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit.

Neni 39

(1) Përfitues të mjeteve të nenit 37 paragrafi (2) nënparagrafi 2 të këtij ligji janë komunat me seli në qytet, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni shpërndahen sipas rajoneve planore në përputhje me klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit.

(3) Mjetet e marra nga instrumentet për ndihmën e paraanëtarësimit IPA nga mjetet e Bashkimit European për zhvillim të qëndrueshëm urban shpërndahen në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit European për rregullat e bashkëpunimit në lidhje me ndihmën financiare të Komisionit European për Republikën e Maqedonisë brenda kornizës së zbatimit të ndihmës nën Instrumentin për ndihmën e paraanëtarësimit (IPA), të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 40

Përfitues të mjeteve nga neni 37 paragrafi (2) nënparagrafi 3 të këtij ligji janë komunat dhe komunat e qytetit të Shkupit, në të cilat identifikohen fushat me nevoja specifike të zhvillimit, si dhe qendrat e zhvillimit të rajoneve planore, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike të formuara nga shteti, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë dhe shoqatat.

Neni 41

(1) Përfitues të mjeteve nga neni 37 paragrafi (2) nënparagrafi 4 të këtij ligji janë njësitë e vetëqeverisjes lokale.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni shpërndahen sipas rajoneve planore, në përputhje me klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit.

Neni 42

Byroja zbaton Vendimin për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, projektet për zhvillimin e zonave urbane, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin e fshatrave nga neni (52) të këtij ligji.

Procedura për mbledhjen dhe vlerësimin e projekteve

Neni 43

(1) Byroja e Zhvillimit Rajonal dërgon njoftim te qendrat për zhvillimin e rajoneve planore jo më vonë se 15 dhjetori i vitit paraprak, duke i informuar për mjetet në dispozicion për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore në vitin e ardhshëm.

(2) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor ka për detyrë të organizojë konsulta rajonale – forume për përcaktimin e një propozim – liste me projektet rajonale, sipas nenit 37, paragrafi 2, nënparagrafi 1 të këtij ligji, në mbështetje të rregullores për mënyrën e organizimit dhe zbatimin e forumeve, që miratohet nga ana e ministrit.

(3) Listën e propozimeve sipas paragrafit 2 të këtij neni, Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor do ta dorëzojë në Këshillin e Zhvillimit të Rajonit Planor.

(4) Për përdorimin e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajonit planor, Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor do të përcaktojë një listë vjetore të projekteve për zhvillimin e rajonit planor. Lista e propozuar duhet të jetë në përputhje me përparësitë në Programin për zhvillimin e rajonit planor.

(5) Projektet për zhvillimin e rajonit planor, për të cilat kërkohet financim vitin e ardhshëm përgatiten nga Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor.

(6) Gjatë përgatitjes së projektit për zhvillimin e rajonit planor janë paraparë edhe mjete për menaxhimin e projektit.

(7) Për menaxhimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore të miratuara për financim, Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor mund të përdorë mjete në vlerë deri 15% të vlerës së projektit (llogaritjes) së projektit të miratuar për financim.

(8) Kriteret themelore për shumën e mjeteve për menaxhimin e projektit të paragrafit (6) të këtij neni janë:

- a) lloji dhe ndërlíkueshmëria e projektit dhe
- b) shuma e vlerës së projektit të projektit.

(9) Ministri përcakton kriteret më të afërta për shumën e mjeteve për menaxhimin e projektit nga paragrafi (6) i këtij neni.

Neni 44

(1) Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor do të paraqesë në Byro, jo më vonë se 31 janari i vitit aktual, projektet e përcaktuara për të cilat kërkohet financim në vitin aktual dhe listën vjetore të projekteve për zhvillimin e rajonit planor.

(2) Rajonet planore që nuk do të paraqesin projekte financuese, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, do të humbasin të drejtën për të përdorur mjetet e ndasra për financimin e projekteve për zhvillimin e rajonit planor në vitin aktual.

(3) Rajonet planore që do të paraqesin projekte për realizimin e të cilave shuma e mjeteve të kërkuara është më e vogël se shuma e plotë e mjeteve të ndara për rajonin e planifikimit për vitin aktual, do të humbasin të drejtën e përdorimit të mjeteve, për të cilat nuk kanë paraqitur një projekt financimi.

(4) Rajonet planore, për projektet e paraqitura, të cilat për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara nuk do të vlerësohen nga komisioni për vlerësimin e propozimeve të projekteve, humbin të drejtën e përdorimit të këtyre mjeteve.

(5) Në Rajonet planore ku mjetet në bazë të paragrafëve (2), (3) dhe (4) të këtij neni mbeten të papërdorura, do t'u shpërndahen shfrytëzuesve – komunave në përbërje të rajonit planor, më saktësisht rajonin e planifikimit në të cilin përfshihet edhe qyteti i Shkupit, komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit për projekte për zhvillimin e zonave urbane, zonave me nevojat specifike të zhvillimit të fshatrave nga lista e projekteve të vlerësuara pozitivisht sipas nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji.

(6) Qeveria, me propozim të Ministrisë dhe nse ka mendim pozitiv paraprak nga Byroja, merr vendim për shpërndarja e mjeteve nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Mjetet e pashfrytëzuara në procedurën e dhënies së kontratës së furnizimit publik për realizimin e projekteve do të përdoren për realizimin e një projekti, i cili për shkak të mungesës së mjeteve financiare ka marrë një shumë më të vogël se sa është kërkuar për realizim të plotë.

(8) Nëse nuk ka ndonjë projekt në përputhje me paragrafin (7) të këtij neni, mjetet do të rishpërndahen në projektet vijuese nga lista vjetore e projekteve për zhvillimin e rajonit planor të cilat vlerësohen pozitivisht sipas nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafi 1 e këtij ligji.

(9) Në Rajonet planore të cilat kanë mjete të papërdorura në bazë të procedurës për dhënien e kontratës së furnizimit publik për realizimin e projekteve dhe nuk kanë një projekt në përputhje me paragrafin (7) dhe (8) të këtij neni, shpërndarja e mjeteve të papërdorura kryhet nga Qeveria, me propozimin e Ministrisë dhe me nismën e me pëlqimin paraprak të Byrosë, për projektet për zhvillimin e zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave nga lista e projekteve të vlerësuara pozitivisht sipas nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, ndërkaq shfrytëzuesit – komunat në përbërje të Rajonit planor, më saktësisht rajoni i planifikimit në të cilin përfshihet edhe qyteti i Shkupit, mjetet do t'u shpërndahen komunave në përbërje të Rajonit planor, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

Neni 45

Nëse gjatë vitit, Byroja zgjidhë një marrëveshje të zbatimit të projektit me shfrytëzuesin, Qeveria, me propozim të Ministrisë, me nismë dhe pëlqim paraprak të Byrosë, me vendim, i shpërndan në projekte për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe fshatrave nga lista e projekteve të vlerësuara pozitivisht, sipas nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, shfrytëzuesve – qendrave për zhvillimin e rajoneve planore ose komunave të të njëjtit rajon planifikimi ose rajoni i planifikimit në të cilin gjendet edhe qyteti i Shkupit, komunave të rajonit planor, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

Neni 46

(1) Nëse gjatë vitit sigurohen mjete shtesë për zhvillim të baraspeshuar rajonal, Qeveria, me propozim të Ministrisë, me nismë dhe pëlqim paraprak të Byrosë, merr vendim për të financuar projekte për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave nga lista e projekteve të vlerësuara pozitivisht, sipas nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji.

(2) Zgjedhja e projekteve sipas paragrafit 1 të këtij neni do të bëhet në bazë të kriterit për cilësinë e projektit, varësisht shumës së mjeteve që janë siguruar më vonë.

Neni 47

(1) Për shpërndarjen e mjeteve nga neni 37 paragrafi (2) nënparagrafi 3 të këtij ligji, Byroja shpall thirrje publike për mbledhjen e projekteve.

(2) Thirrja publike nga paragrafi (1) i këtij neni tregon shumën totale të mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim.

(3) Të drejtë për të dorëzuar projekte kanë komunat dhe komunat e qytetit të Shkupit në të cilat janë përcaktuar rajonet me nevoja zhvillimi specifike dhe qendrat e zhvillimit të rajoneve planore, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike të formuara nga shteti, komunat dhe komunat e qytetit të Shkupit, institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë dhe shoqatat.

Neni 48

(1) Për shpërndarjen e mjeteve nga neni 37 paragrafi (2) paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji, Byroja shpall thirrje publike për mbledhjen e propozimeve të projekteve.

(2) Thirrja publike nga paragrafi (1) i këtij neni tregon shumën totale të mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e zonave urbane dhe fshatrave, veçmas për secilin rajon.

(3) Komunat me seli në qytet dhe komunat në qytetin e Shkupit që i përkasin rajonit planor kanë të drejtë të paraqesin projekte të propozuara për zhvillimin e zonave urbane.

(4) Njësitë e vetëqeverisjes lokale që i përkasin rajonit planor kanë të drejtë të paraqesin projekte të propozuara për zhvillimin e fshatit.

(5) Njësitë e vetëqeverisjes lokale me seli në qytet që paraqesin projekte për zhvillimin e fshatrave që janë pjesë e tyre, janë të detyruar të sigurojnë bashkëfinancim të projektit në vlerë prej 50% të vlerës së projektit.

(6) Bashkëfinancimi i projekteve mund të sigurohet nga burimet e veta të të ardhurave dhe nga burime të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

(7) Njësitë e vetëqeverisjes lokale me seli në fshat nuk kanë asnjë detyrim për të bashkëfinancuar projektet.

Neni 49

(1) Projektet për zhvillimin e rajoneve planore, projektet për zhvillimin e zonave urbane, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe projektet për zhvillimin rural, të cilat paraqiten për financim nëpërmjet një formulari aplikimi, në përputhje me udhëzimet e aplikimit të botuara nga Byroja, patjetër duhet të përmbajë elementet e mëposhtëm:

- emri i projektit,
- bartësi i projektit,
- objektivat e projektit,
- rezultatet e pritura nga projekti,
- konstruksioni financiar i projektit,
- kohëzgjatja dhe dinamika e realizimit të projektit dhe
- elemente të tjera në varësi të specifikave të projektit.

(2) Në projektet për zhvillimin e rajoneve planore, projektet për zhvillimin e zonave urbane, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin e fshatrave, tregohet lidhja e projektit me përparësitë nga Programi për zhvillimin e rajonit planor sipas nenit 13 të këtij ligji dhe Programit për implementimin e Strategjisë sipas nenit 11, paragrafi 3 të këtij ligji.

(3) Nëse në periudhën e dorëzimit të propozimeve të projektit nga paragrafi (1) i këtij neni, dokumentet e planifikimit nuk miratohen brenda afatit të përcaktuar me ligj, paraqitësit tregojnë lidhjen e projektit me përparësitë e Programit për zhvillimin e rajonit planor sipas nenit 13 të këtij ligji ose Programit për implementimin e Strategjisë sipas nenit 11, paragrafi 4 të këtij ligji nga periudha e mëparshme e planifikimit.

Neni 50

1) Për të vlerësuar projekt propozimet e paraqitura për zhvillimin e rajoneve planore, projektet për zhvillimin e zonave urbane, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin rural, si dhe për projektet që financohen me mjetet sipas nenit 57, paragrafi 1, do të themelohet një Komision i vlerësimit të projekteve.

(2) Komisioni i formuar nga Ministri, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.

(3) Kryetari i Komisionit emërohet nga radhët e nëpunësve shtetërorë në poste drejtuese nga njësia organizative për zhvillim të baraspeshuar rajonal në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale.

(4) Një anëtar i Komisionit emërohet nga radhët e nëpunësve shtetërorë nga Kabineti i Zëvendëskryeministrit, i ngarkuar me çështjet ekonomike, të bashkërendimin me departamentet ekonomike dhe investimet.

(5) Një anëtar i Komisionit do të emërohet nga radhët e nëpunësve shtetërorë nga Byroja.

(6) Dy anëtarë, me propozim të Ministrit, emërohen nga radhët e ekspertëve në fushën e ndërtimit, arkitekturës, shkencave juridike dhe ekonomike,

(7) Komisioni i vlerësimit të projektit shqyrton dhe vlerëson projekt-propozimet e paraqitura të paragrafit (1) të këtij neni dhe përcakton shumën e mjeteve të planifikuara për menaxhimin e projektit për zhvillimin e rajoneve planore.

Neni 51

(1) Projektet për zhvillimin e rajoneve planore, projektet për zhvillimin e zonave urbane, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin e fshatrave dalin nga prioritetet e përcaktuara në Programin për zhvillimin e rajonit planor.

(2) Projektet nga paragrafi (1) i këtij neni që nuk përmbushin kushtin sipas prioriteteve të përcaktuara në Programin për zhvillimin e rajonit planor nuk do të merren parasysh.

(3) Ministri përcakton mënyrën dhe metodologjinë për vlerësimin e propozimeve të projekteve.

Dhënia e mjeteve për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal

Neni 52

(1) Pas vlerësimit të projekt propozimeve, Komisioni përgatit listat e propozuara për financim të:

- projekteve për zhvillimin e rajoneve planore,
- projekteve për zhvillimin e zonave urbane,
- projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe
- projekteve të zhvillimit rural.

(2) Propozim-listat nga paragrafi (1) nënparagrafët 1, 2 dhe 4 të këtij neni, përgatiten veçmas për secilin rajon.

(3) Ministri paraqet propozim-listat nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Pas vlerësimit të projekteve, Komisioni do të përgatitë listë për financimin e:

- projekteve specifike për zhvillimin e rajoneve planore,
- projektet për zhvillimin e zonave urbane,
- projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe
- projektet për zhvillimin rural.

(5) Këshilli, në bazë të listave të propozimeve, përcakton një propozim për financimin e projekteve specifike për zhvillimin e rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja të veçanta zhvillimore dhe fshatrave me vendim.

(6) Gjatë përcaktimit të propozimit për financimin e projekteve për zhvillim, zhvillim të rajoneve planore, zonave urbane, zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe fshatrave, Këshilli do të marrë parasysh përfaqësimin e barabartë në shpërndarjen e mjeteve për të gjitha komunat që i përkasin rajonit planor.

Neni 53

Bazuar në propozim - listat e përmendura në nenin 52 paragrafi (5) të këtij ligji, Qeveria do të miratojë një vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, projekteve për zhvillimin e zonave urbane, projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike të zhvillimit dhe projekteve për zhvillimin rural.

Neni 54

Mjetet nga neni 53 të këtij ligji do të shpërndahen për llogari të Byrosë së Zhvillimit Rajonal që zbaton vendimin e nenit 53 të këtij ligji.

Neni 55

(1) Bazuar në Vendimin e nenit 53 të këtij ligji, Byroja lidh marrëveshje për realizimin e projekteve.

(2) Marrëveshjet për realizimin e projekteve për zhvillimin e rajonit planor lidhen me qendrat për zhvillimin e rajoneve planore. Qendrat zbatojnë projektet në bashkëpunim me komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit, të cilave u referohen.

(3) Marrëveshjet për zbatimin e projekteve për zhvillimin e zonave urbane dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin e fshatrave lidhen me njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilët janë bartës të projekteve.

(4) Marrëveshjet për zbatimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimi lidhen me komunat, komunat e qytetit të Shkupit, qendrat për zhvillimin e rajoneve planore, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike të formuara nga shteti, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë dhe shoqatat.

(5) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet mënyra e përdorimit të mjeteve të shpërndara dhe shuma e mjeteve për menaxhimin e projekteve nga neni 43 paragrafi (6) të këtij ligji.

Neni 56

Byroja organizon, zbaton dhe bashkërendon vizita terreni për monitorimin e mënyrës së realizimit të projekteve të parapara me nenin 53 të këtij ligji, në bazë të mënyrës dhe procedurës për monitorimin e realizimit të projekteve dhe zhvillimin e vizitave në terren, të përcaktuara me një akt që miratohet nga ana e Ministrit, me propozim të Byrosë.

Shpërndarja e mjeteve për uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe rritjen e konkurrencës rajonale

Neni 57

(1) Ministria zbaton program për uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe për rritjen e konkurrencës rajonale;

(2) Në kuadër të programit të paragrafit 1 të këtij neni do të mbështeten aktivitetet e ndërtimit të objekteve që kanë për qëllim përmirësimin e qasjes në infrastrukturën në nivelin e rajoneve planore dhe në nivel lokal, si dhe aktivitetet nga neni 36, paragrafi 2 të këtij ligji;

(3) Mjetet për zbatimin e programit sipas paragrafit 1 të këtij neni, parashihen me Buxhetin e Ministrisë;

(4) Qeveria, me propozim të ministrit, miraton programin e paraparë me paragrafin (1) të këtij neni;

(5) Në programin e paraparë me paragrafin (1) të këtij neni theksohen masat prioritare dhe aktivitetet për uljen e dallimeve në aspektin e zhvillimit midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe për rritjen e konkurrencës rajonale, që do të fitojnë mbështetje financiare gjatë vitit aktual, projekte që dalin nga prioritetet e parapara me dokumentet e planifikimit për zhvillimin rajonal.

Neni 58

(1) Brenda 15 ditëve pas miratimit të programit të paraparë me nenin 57, paragrafi 1 të këtij ligji, Ministria do të shpall thirrje të hapur publike për financimin e projekteve sipas masave dhe aktiviteteve për zhvillim të barabartë rajonal, të parapara me Programin sipas nenit 57, paragrafi 1 të këtij ligji në ueb faqen e saj dhe në dy medie të shkruara, njëra prej të cilave në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe mbetet e hapur deri në shfrytëzimin e mjeteve.

(2) Thirrja e hapur publike nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

- kushtet e pjesëmarrjes në thirrjen publike,
- kriteret në bazë të të cilave do të bëhet vlerësimi i projekteve,
- afatin e dorëzimit të projekteve,
- informacione të tjera.

(3) Përfitues të mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni janë qendrat për zhvillimin e rajoneve planore, komunat, komunat e qytetit të Shkupit, qyteti i Shkupit, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike të themeluara nga shteti, komunat dhe qyteti i Shkupit, shoqatat, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore.

(4) Shfrytëzuesit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, paraqesin aplikacionet e tyre për projekte në një formë, e cila është e botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, me udhëzimet e bashkangjitura të aplikacioneve.

(5) Projekt-propozimet nga paragrafi (4) i këtij neni vlerësohen nga Komisioni sipas nenit 50, paragrafi 1 të këtij ligji.

(6) Vlerësimi i projekteve do të bëhet në mbështetje të aktit të paraparë me nenin 51, paragrafi 3 të këtij ligji.

(7) Me programin sipas nenit 57, paragrafi 1 të këtij ligji, mund të bashkëfinancohen edhe projekte të përcaktuara me vendim të Qeverisë sipas nenit 53 të këtij ligji, për të cilat janë miratuar më pak mjete sesa të miratuara, për përfundimin e plotë të projektit.

(8) Në kuadër të programit të paraparë me nenin 57, paragrafi 1 të këtij ligji, mund të financohen dhe bashkëfinancohen edhe projekte që zbatohen nga Ministria, të siguruara me donacione të subjekteve vendase dhe të huaja dhe me burime të tjera, në kuadër të kornizës ligjore, lidhur me politikën e zhvillimit të baraspeshuar rajonal, nën kompetencat e Ministrisë, që janë paraparë me këtë ligj.

Neni 59

(1) Vlerësimi i propozim-projekteve të fituara fillon pas përfundimit të afatit prej 30 ditësh nga shpallja e thirrjes publike të nenit 58, paragrafi 1 të këtij ligji dhe zbatohet gjatë të gjithë vitit buxhetor, sipas dinamikës së sigurimit të projekteve.

(2) Pas vlerësimit të propozim-projekteve, të paragrafit 1 të këtij neni, Komisioni i nenit 50, paragrafi 1 të këtij ligji, përgatitë raport me vlerësimin e kryer të projekteve, me një listë propozimi për financimin e projekteve me vlerësim pozitiv, listë kjo që i dorëzohet ministrit.

(3) Ministri, brenda 30 ditëve nga pranimi i raportit të paraparë me paragrafin 2 të këtij neni, do të marr vendim për zgjedhjen e projekteve që do të financohen me programin e paraparë me nenin 57, paragrafi 1 të këtij ligji.

(4) Në rast se në kuadër të listës nga paragrafi 2 i këtij neni do të propozohet një projekt për të cilin nevojitet financim shumëvjeçar. Ministri mund ta zgjedh të njëjtin, pas sigurimit të mendimi pozitiv paraprak nga Qeveria.

(5) Në uebfaqen e Ministrisë do të publikohen rezultatet e zgjedhjes, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

(6) Në ueb faqen e Ministrisë do të publikohen edhe të dhënat për projektet që nuk janë zgjedhur me thirrjen publike të nenit 58, paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 60

Projektet e zgjedhura për t'u financuar sipas thirrjes publike të paraparë me nenin 58, paragrafi 1 të këtij ligji, duhet të realizohen deri në fund të vitit aktual, me përjashtim të projekteve për të cilat është lejuar financimi shumëvjeçar, si dhe projekteve dhe aktiviteteve që zbatohen nga Ministria.

Neni 61

(1) Ministria lidh kontrata me shfrytëzuesit e projekteve të nenit 59, paragrafi 3 të këtij ligji për financimin e projekteve për uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe rritjen e konkurrencës rajonale.

(2) Me kontratën nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen: emri i projektit për të cilin ndahen mjetet, shuma e mjeteve, mënyra e përdorimit të mjeteve, dinamika dhe afati i realizimit të projektit, dorëzimi i raporteve lidhur me projektin, monitorimi i përdorimit qëllimor të mjeteve, sanksionet për mospërbushjen e detyrimeve të kontratës dhe çështje të tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesve.

(3) Për kontratën nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen dispozitat nga sfera e marrëdhënieve detyrimore.

Neni 62

(1) Shfrytëzuesit detyrohen t'i shfrytëzojnë mjetet e dhëna me Programin e nenit 57, paragrafi 1 të këtij ligji, sipas qëllimit përkatës.

(2) Shfrytëzuesit e projekteve dorëzojnë raporte gjysmëvjeçare lidhur me shkallën e realizimit të projekteve të miratuara sipas nenit 59, paragrafi 3 të këtij ligji. Në rast se me kontratën nga neni 61, paragrafi 1 të këtij ligji është paraparë realizimi i projektit në faza, shfrytëzuesit kanë për detyrë që pas përfundimit të çdo faze të dorëzojnë në ministrinë kompetente raport për realizimin e projektit.

(3) Në një afat prej 30 ditësh pas përfundimit të projektit, shfrytëzuesit kanë për detyrë të dorëzojnë në ministri raport për realizimin e projektit, që përmban pjesë përshkruese, specifikim të shumës së përgjithshme të mjeteve të shfrytëzuara nga Ministria, për realizimin e projektit, duke dorëzuar dokumente financiare.

(4) Ministria do të mbikëqyrë shfrytëzimin e mjeteve gjatë realizimit të kontratave të lidhura sipas nenit 61, paragrafi 1 të këtij ligji, nëpërmjet raporteve për realizimin e projekteve për të cilat janë ndarë mjete.

(5) Në rast se do të vërtetohet se mjetet e ndara përdoren në kundërshtim të kontratës nga neni 61, paragrafi 1 të këtij ligji ose do të konstatohet se shfrytëzuesit nuk i shfrytëzojnë drejtë mjetet e mundësuar ose nuk i respektojnë afatet dhe detyrimet e kontratës, Ministria njëanshëm do të prish kontratat, do të ndërpresë financimin e mëtejshëm të projekteve, ndërkaq shfrytëzuesit kanë për detyrë që brenda 30 ditëve të kthejnë mjetet e mundësuar në ministrinë kompetente.

(6) Në rast se shfrytëzuesit brenda afatit të paraparë me paragrafin 5 të këtij neni nuk do t'i kthejnë mjetet e mundësuar, ministria do të nis një procedurë në gjykatën kompetente për kthimin e mjeteve të mundësuar, të cilat do të rriten me shumat e kamatës, në mbështetje të ligjit.

VIII. SHPËRNDARJA E MJETEVE PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARASPESHUAR RAJONAL ME NDIHMËN E PROGRAMEVE / NËNPOGRAMEVE TË TJERA

Neni 63

(1) Financimi i zhvillimit të baraspeshuar rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të bëhet edhe me ndihmën e programeve që realizohen nga ministritë e linjës dhe organet e tjera të administratës së shtetit.

(2) Rëndësia e programeve për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal do të përcaktohet në bazë të vlerësimit të kontributit të programit në uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore. Programet detyrimisht duhet të marrin parasysh shkallën e zhvillimit të rajoneve planore, si një nga kriteret në rastin e ndarjes së mjeteve.

(3) Propozim-programet për vitin e ardhshëm, të cilat ministritë resore dhe organet e tjera të administratës shtetërore, që janë me rëndësi për zhvillimin e baraspeshuar rajonal dhe janë pjesë e kërkesës së tyre propozim – buxhetore, duhet t'i dorëzojnë në Këshillin për zhvillim të baraspeshuar rajonal gjatë periudhës para miratimit të projekt – programeve të ministrive kompetente nga ana e Qeverisë.

(4) Vlerësimi i rëndësisë së programeve konkrete për uljen e pabarazisë në aspektin e zhvillimit midis dhe në Rajonet planore e bën Ministria dhe ajo merret me dorëzimin në Këshillin për zhvillim të baraspeshuar rajonal gjatë periudhës para miratimit të tyre nga ana e Qeverisë.

(5) Kriteria kryesore për vlerësim janë si më poshtë: vendi në të cilin zbatohet projekti dhe lidhja e tij me prioritetet e Programit për zhvillimin e rajonit planor dhe shkalla e zhvillimit të rajonit planor, sipas nenit 34, paragrafi 1 të këtij ligji.

(6) Qeveria, me propozim të Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal, përcakton kriteret më të afërta për vlerësimin sipas paragrafit 4 të këtij neni i përcakton Qeveria, me propozim të.

(7) Në rastet kur gjatë vitit aktual nga programet e paragrafit 1 të këtij neni, rajonit planor do t'i ndahen më pak mjete në raport me shumën e përlogaritur për rajonin e planifikimit, në mbështetje të nivelit të zhvillimit sipas nenit 34, paragrafi 1 të këtij ligji, me propozim të Këshillit, Qeveria me një akt konkret do të detyrojë organet shtetërore kompetente që në vitin e ri buxhetor të mbulojnë mungesën e shumës përkatëse.

IX. NDJEKJA DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT DHE I PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Ndjekja e zbatimit të dokumenteve të planifikimit të zhvillimit rajonal

Neni 64

(1) Ndjekja e zbatimit të Strategjisë së zhvillimit rajonal do të realizohet nga Qeveria, nëpërmjet Raportit vjetor për zbatimin e Strategjisë.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përgatitet nga Ministria dhe i paraqitet Qeverisë për informim, me mendimin paraprak të Këshillit të Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal deri në fund të vitit aktual, për vitin paraprak.

Neni 65

(1) Ndjekja e zbatimit të Programit për zhvillimin e rajonit planor realizohet nga Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal, Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor dhe këshillat e komunave që i përkasin rajonit planor, nëpërmjet raportit vjetor për realizimin e Programit.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga një pjesë përshkuese dhe tabelore.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht përmban të dhënat e mëposhtme:

- lista e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara brenda secilës masë individuale, në përputhje me përparësitë strategjike të përcaktuara në Programin për zhvillimin e rajonit planor,

- burimet financiare,

- mjete të realizuara për implementimin e secilit projekt individual dhe aktivitet nga paragrafi

(2) nënparagrafi 1 e këtij neni,

- fusha e realizimit,

- emrin e shfrytëzuesit të secilit projekt individual nga paragrafi (2) nënparagrafi 1 e këtij neni dhe

- tregues për matjen e suksesit të masës / secilit projekt individual nga paragrafi (2) nënparagrafi 1 e këtij neni.

(4) Ministri e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përgatitet nga Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor dhe i paraqitet Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor.

(6) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni paraqitet nga Këshilli i Zhvillimit të Rajonit Planor të Ministria, Këshilli i Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal dhe këshillat e komunave që i përkasin rajonit planor.

Ndjekja e përdorimit të mjeteve për nxitjen zhvillimit rajonal të barabartë

Neni 66

(1) Ndjekja e përdorimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal nga neni 37 paragrafi (2) të këtij ligji do të kryhet nga Byroja nëpërmjet raporteve për realizimin e projekteve për të cilat janë ndarë burimet financiare.

(2) Për projektet për zhvillimin e rajoneve planore, raportet për realizim përgatiten nga Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor dhe i dorëzohen Byrosë në përputhje me dinamikën kohore të përcaktuar në kontratën për realizimin e projektit.

(3) Për projektet për zhvillimin urban dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike për zhvillim dhe projektet për zhvillimin rural, raportet e realizimit përgatiten nga bartësit e projekteve dhe i paraqiten Byrosë në përputhje me dinamikën kohore të përcaktuar në kontratë për realizimin e projektit.

(4) Ministritë përgjegjëse për realizimin e programeve dhe projekteve me rëndësi për zhvillimin e baraspeshuar rajonal duhet t'i paraqesin Ministrisë të dhëna për realizimin e programeve dhe projekteve që do të përdoren për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimin e masave dhe instrumenteve për inkurajim e zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

(5) Të dhënat nga paragrafi (4) i këtij neni arkivohen në sistemin elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

Vlerësimi i dokumenteve të planifikimit të zhvillimit rajonal

Neni 67

Strategjia e zhvillimit rajonal dhe Programi i zhvillimit të rajonit planor vlerësohen nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar.

Neni 68

(1) Vlerësimi aktual i Strategjisë së Zhvillimit Rajonal dhe i programeve për zhvillimin e rajoneve planore do të realizohet në mes të periudhës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

(2) Me vlerësimin aktual bëhet vlerësimi i realizimit dhe i efekteve të masave të zbatuara për nxitjen e zhvillimit rajonal, të identifikuar në Strategji dhe Programet për zhvillimin e rajoneve planore.

Neni 69

(1) Vlerësimi përfundimtar realizohet pas përfundimit të periudhës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

(2) Me vlerësimin përfundimtar bëhet vlerësimi i shkallës së realizimit të dokumentit të planifikimit, përmbushja e përparësive dhe e qëllimeve të dokumenteve të planifikimit dhe efektet e arritura për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal.

Neni 70

(1) Për vlerësimin e kryer aktual dhe përfundimtar përgatiten raporte të cilat janë baza për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të planifikimit.

(2) Ministri e përcakton mënyrën e përzgjedhjes së vlerësuesve dhe metodologjinë e vlerësimit, sipas nenit 51, paragrafi 3.

Vlerësimi i realizimit të projekteve të financuara nga programi për zhvillim rajonal / nën – programi - zhvillimi i baraspeshuar rajonal

Neni 71

Vlerësimi i realizimit të projekteve për zhvillimin e zonave urbane dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike zhvillimore dhe projekteve për zhvillimin e fshatrave të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal, bëhet nëpërmjet vlerësimit paraprak, të vazhdueshëm dhe përfundimtar.

Neni 72

(1) Vlerësimi paraprak realizohet për projektet e paraqitura për financim nga mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

(2) Vlerësimi paraprak i projekteve bën një vlerësim të përmbushjes së kushteve të parapara për financim nga mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për të nxitur zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

(3) Vlerësimi paraprak i projekteve realizohet nga Komisioni për vlerësimin e projekteve në mbështetje të nenit 50 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 73

(1) Vlerësimi aktual i projekteve realizohet gjatë realizimit të projekteve.

(2) Vlerësimi aktual i projekteve vlerëson përshtatshmërinë e përdorimit të mjeteve, respektimin e dinamikës kohore për realizimin e aktiviteteve të parashikuara dhe efektet e realizimit të tyre.

Neni 74

(1) Vlerësimi përfundimtar i projekteve realizohet pas përfundimit të projekteve.

(2) Vlerësimi përfundimtar bën një vlerësim të suksesit të përgjithshëm për realizimin e projektit, përshtatshmërisë së përdorimit të mjeteve, përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara dhe realizimit të rezultateve të pritura.

Neni 75

(1) Për vlerësimin paraprak, aktual dhe përfundimtar përgatiten raporte të cilat janë baza për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të planifikimit.

(2) Mënyra e përzgjedhjes së vlerësuesve dhe metodologjia për vlerësimin aktual dhe përfundimtar të projekteve përcaktohet nga Ministri.

Vlerësimi i realizimit të projekteve për zhvillim të baraspeshuar rajonal të financuar nga programe të tjera

Neni 76

Vlerësimi i realizimit të projekteve të rëndësishme për zhvillimin e baraspeshuar rajonal, të financuar nga programe të tjera bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara të ministrive të linjës.

X. SISTEMI ELEKTRONIK PËR BASHKËRENDIMIN E PLANIFIKIMIT, TË ZBATIMIT, TË NDJEKJES DHE TË VLERËSIMIT TË POLITIKËS PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARASPESHUAR RAJONAL

Neni 77

(1) Sistemi elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimin të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal kryen mbledhjen, përdorimin dhe arkivimin e të dhënave dhe informacionit të rëndësishëm për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikës për zhvillimin e baraspeshuar rajonal.

(2) Organi shtetëror kompetent për mirëmbajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e sistemit elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimin të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal është Ministria.

(3) Sistemi elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimin të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal ofron një bazë të dokumentacionit përkatës të projekteve të realizuara, aktuale dhe të planifikuara me rëndësi për zhvillimin e baraspeshuar rajonal, monitorimin statistikor dhe rishikimet e nivelit të zhvillimit të rajoneve, si dhe informacion mbi lidhjen e programeve me burimet e financimit.

(4) Të dhënat dhe informacionet nga sistemi elektronik për bashkërendimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimin të politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal do të jenë baza për bashkërendimin dhe harmonizimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal me politikën dhe programet e tjera.

(5) Ministrinë dhe organet e tjera të administratës së shtetit që zbatojnë programe / projekte me rëndësi për zhvillimin rajonal kanë për detyrë të dorëzojnë në Ministrinë raporte tremujore lidhur me përdorimin e mjeteve për zhvillimin rajonal.

XI. MBIKËQYRJA

Neni 78

Ministria kryen mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Neni 79

Ministria e Financave dhe Enti Shtetëror i Revizionit kryejnë kontroll financiar të funksionimit materialo-financiar të Byrosë dhe të qendrave për zhvillimin e rajoneve planore.

XII. DISPOZITA PARAPRAKE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 80

Sistemi elektronik për përmirësimin e bashkërendimit në planifikimin, zbatimin, ndjekjen dhe vlerësimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal do të vendoset brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 81

Programi i parë trevjeçar nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji do të miratohet nga Qeveria brenda gjashtë muajve nga miratimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Neni 82

(1) Byroja e Zhvillimit Rajonal vazhdon të punojë si organ i administratës së shtetit, në përbërje të Ministrisë së Vetqeverisjes Lokale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(2) Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore, të cilat janë themeluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji në përputhje me Ligjin për zhvillim të baraspeshuar rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 63/2007, 187/13, 43/14, 215 / 15 dhe 64/18), vazhdojnë të punojnë dhe ushtrojnë aktivitete në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 83

Drejtori i Byrosë së Zhvillimit Rajonal i emëruar nga Qeveria deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me Ligjin e Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 63/2007, 187/13, 43/14, 215/15 dhe 64/18), e ushtron funksionin deri në përfundimin e afatit të mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 84

(1) Drejtuesit e Qendrave për zhvillimin e rajoneve planore të zgjedhur nga Këshillat për zhvillimin e rajoneve planore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në mbështetje të Ligjit për zhvillim të baraspeshuar rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 63/2007, 187/13, 43/14, 215/15 dhe 64/18), do të vazhdojnë të ushtrojnë detyrat sipas këtij ligji, deri në përfundimin e mandatit për të cilin janë zgjedhur.

(2) Riemërimi i drejtuesve të qendrave për zhvillimin e rajoneve planore në detyrën e drejtorëve, në bazë të nenit 37 të këtij ligji, do të bëhet me ndryshimin e aktit të themelimit të Qendrës, neni 26 paragrafi 5 të këtij ligji dhe me aktin e Këshillit të Zhvillimit të Rajonit Planor, brenda afatit të paraparë me nenin 86 të këtij ligji.

Neni 85

Vendimi për klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 234/18), Vendimi për përcaktimin e zonave për nevoja specifike të zhvillimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 263/19), Rregullorja e procedurës dhe e metodologjisë së vlerësimit të propozimeve të projektit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/20), Rregullorja e përcaktimit të kriterëve më të afërta për shumën e mjeteve për menaxhimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore që janë miratuar për financim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 57/16) dhe Rregullorja e metodologjisë së përgatitjes së dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 102/2009), vazhdojnë të zbatohen deri në miratimin e vendimeve dhe rregulloreve të këtij ligji.

Neni 86

(1) Komunat në përbërje të rajoneve planore, rajoni i planifikimit në të cilin përfshihet qyteti i Shkupit dhe qyteti i Shkupit, kanë për detyrë që brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të harmonizojnë aktin për formimin e Qendrës së Zhvillimit të Rajonit Planor të paraparë me nenin 26, paragrafi 5, me dispozitat e këtij ligji.

(2) Këshillat për zhvillimin e rajoneve planore kanë për detyrë që në një afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të harmonizojnë aktet e tyre me dispozitat e këtij ligji.

Neni 87

(1) Personat që kanë fituar të drejtën për të paguar kontribute për pension, paaftësi dhe sigurim shëndetësor në përputhje me Ligjin e Nxitjes së Zhvillimit të Zonave me Zhvillim të Pamjaftueshëm Ekonomik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 2/94 dhe 39/99), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë ta përdorin të njëjtën deri në realizimin e pensionit, në përputhje me ligjin.

(2) Mjetet për ushtrimin e së drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohen nga mjetet e nenit 37 paragrafi (2) nënparagrafi 1 të këtij ligji.

Neni 88

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 89

Dispozitat e nenit 21, paragrafi 5 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas zhvillimit të zgjedhjeve të reja lokale.

Neni 90

Dispozitat e neneve 58, 59, 60, 61 dhe 62 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Neni 91

Programin e paraparë me nenin 57 paragrafi 1 të këtij ligji në vitin 2021 do ta zbatojë Byroja në kuadër të Programit për zhvillimin e baraspeshuar rajonal në vitin 2021 dhe në këtë kontekst, me pëlqimin e Ministrisë mjetet për financimin e aktiviteteve për uljen e pabarazisë midis dhe në kuadër të rajoneve planore dhe rritjen e konkurrencës rajonale do të caktohen në mënyrë procentuale, si pjesë e mjeteve të përgjithshme për nxitjen e zhvillimit të baraspeshuar rajonal në vitin aktual.

Neni 92

Dispozitat e nenit 2, paragrafët 15, 16, paragrafi 3 (I) paragrafët 5, 6 dhe 12, paragrafi 2, paragrafët 12 dhe 15, paragrafi 1, nënparagrafi 13 dhe paragrafi 2, paragrafi 8 (1), paragrafët 8 dhe 9, paragrafi 26 (1), paragrafët 6 dhe 7, paragrafi 37 (2), paragrafët 2 dhe 39, paragrafët 3, 42 dhe 44, paragrafët 5 dhe 9, 45 dhe 46, paragrafi 1, paragrafi 48 (2) dhe (3), paragrafi 49 (1) dhe (2), paragrafët 50 dhe 51 (1), paragrafi 52 (1), (4), (5) dhe (6), paragrafët 53 dhe 55 (3), 66 dhe 71 të këtij ligji do të zbatohen deri në anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

Neni 93

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohet Ligji i Zhvillimit të Barabartë Rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 63/2007, 187/13, 43/14, 15/15 dhe 64/18).

Neni 94

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".